



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ - DEGA E GJYKATËS KAÇANIK

Numri i lëndës: 2023:165783

Datë: 27.12.2024

Numri i dokumentit: 06660812

2023:165784

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ – Dega në Kaçanik, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, me gjyqtaren Alba Makolli, me sekretaren juridike Shpresa Hoxha, në çështjen juridike kontestimore të paditëses K.B., të cilën e përfaqëson sipas autorizimit Q.B. avokat nga Kaçaniku, kundër të paditurës Komuna Han i Elezit - Drejtoria e Arsimit, të cilën e përfaqëson Bajrush Laçi, me objekt të padisë kompensim i shujtave dhe udhëtimit, pas përfundimit të seancës së shqyrtimit kryesor publik me datë 18.12.2024, kurse me datë 27.12.2024 mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET PJESËRISHT kërkesëpadia e paditëses K.B. nga Han i Elezit, ashtu që DETYROHET e paditura Komuna e Hanit të Elezit - Drejtoria e Arsimit që paditëses K.B. në emër të kompensimit për ushqim gjatë punës (shujtat ditore), për 263 ditë pune për periudhën nga data 22.01.2021 deri me 21.11.2022, t’ia paguaj shumën në lartësi prej 526,00 euro, me kamatë ligjore prej 8% në vit, nga data e parashtrimit të padisë e deri në pagesën definitive, në afat prej 7 ditësh nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit me dhunë.

II. REFUZOHET pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditëses, me të cilën ka kërkuar që e paditura Komuna Hani i Elezit në emër të shpenzimeve të udhëtimit t’ia paguajë shumën në lartësi prej 1,104.60 euro për 263 ditë pune, si e pabazuar.

III. DETYROHET e paditura Komuna Hani Elezit-Drejtoria e Arsimit, që paditëses t’ia paguaj shumën si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 404.40€, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit.

A r s y e t i m

Paditësja përmes të autorizuarit të saj, me datë 26.07.2023, ka parashtruar padi kundër të paditurës me objekt të kontestit, kompensim i shujtave dhe udhëtimit. Në padi ka theksuar se paditësja është në marrëdhënie pune në shkollën fillore të mesme të ulët “...” në Han të Elezit, si mësimdhënëse e mësimit klasor, ku ka vijuar me rregull nga data 22.01.2021 deri me datë 30.12.2022, për të njëjtën Drejtoria e Arsimit në Komunë, nuk ka bërë kompensimin e ushqimit dhe udhëtimit në mënyrë vullnetare siç e përcakton kontrata Kolektive e Arsimit. Kështu, i është referuar kësaj kontrate përkatësisht nenit 35 pika 5 dhe pika 7, sa i përket shujtave si dhe udhëtimit, andaj kjo dispozitë vërteton të drejtën e paditëses. Me precizimin e kërkesëpadsisë të datës 17.11.2023, ka propozuar që paditëses t’i paguhet shuma në emër të shujtave ditore prej 526 euro për 263 ditë pune dhe në emër të shpenzimeve të udhëtimit 1,104.60 euro për 263 ditë pune, me kamatë prej 8% nga dita e arritjes së e detyrimit.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

E paditura nuk ka paraqitur përgjigje në padi, por përgjatë seancave të mbajtura dhe në fjalën përfundimtare, ka theksuar se nga certifikata e lindjes të paditëses rezulton se e njëjta e ka vendbanimin në Çair –Shkup, që bie në kundërshtim të plotë me kontratën kolektive të arsimit, referuar dispozitës së nenit 35 paragrafit 5. Nga provat e administruara, vërtetohet se paditësja nuk udhëton brenda vendbanimit të komunës ku edhe punon, nuk ka as kupon të transportit urban dhe distanca mes kufirit të Maqedonisë së Veriut ku është hyrja në territorin e Komunës e deri tek shkolla ku paditësja punon është një distancë për afërsisht 2 km. Andaj, i propozon gjykatës që pjesën e kërkesëpadsisë sa i përket shpenzimeve të udhëtimit ta refuzoj, ndërsa sa i përket kërkesëpadsisë së shujtave ne parimisht jemi pajtuar edhe me lëndët tjera me paditës të tjerë, megjithatë kërkoj që mos të llogaritet kamata ligjore prej 8%.

Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, lidhur me çështjen konkrete juridike, në shqyrtimin kryesor-publik, gjykata bëri administrimin e provave si: Kontratë pune për mësimdhënëse nr. 05/8542/2020 në mes të Komunës Hani i Elezit dhe K.B., bileta 06437 në gjuhën maqedone, bileta 06436 në gjuhën maqedone, certifikatë nga libri Amëz i të lindurve me

numër serik e dt. 16.12.2024, certifikatë nga libri amëz i të kurorëzuarve me nr. serike dt. 16.12.2024 dhe vërtetim me numër 125/23 i datës 13.11.2023.

Gjykata pas vlerësimit të pohimeve të palëve ndërgjyqëse dhe provave të nxjerra në kuptim të nenit 8 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha ato së bashku, ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar.

Nga kontrata e punës për mësimdhënës nr. 05/8542/2020 në mes të Komunës Hani i Elezit dhe K.B., rrjedh se paditësja është e punësuar në këtë komunë si mësimdhënëse e mësimi klasor në SHFMU “...” në Han të Elezit.

Me leximin e vërtetimit të lëshuar nga SHFMU “...” me nr.125/23 i datës 13.11.2023, gjykata ka vërtetuar se paditësja K.B. në periudhën prej datës 22.01.2021 deri me datë 21.11.2022, ka realizuar ditë pune dhe ditë mësimi 263 ditë.

Nga certifikata nga libri amëz i të lindurve me numër serik e dt. 16.12.2024, vërtetohet se K.B. ka lindur në Han të Elezit në Kosovë, kurse është qytetare e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Nga certifikata nga libri amëz i të kurorëzuarve me nr. serik 0091045 e dt. 16.12.2024, rrjedh se paditësja K.B. është e martuar me F.B.

Sipas nenit 35 paragrafi 7 i Kontratës Kolektive nr. 105 e datës 22.01.2021 parashihet që *“Të punësuarve (anëtarë të SBASHKU-ut) u sigurohet kompensim për ushqim gjatë punës, për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimit të ushqimit në punë, për një ditë pune, është dy euro për të punësuarit që kanë marrëdhënien e punës primare në institucionet arsimore. Punëdhënësi, i cili ka të rregulluar ushqimin e të punësuarve, përmes restorantit, kuzhinës, ose në një formë tjetër, nuk ka obligim pagese të të punësuarve për ushqim.”*

Gjykata pas vlerësimit të provave konstaton se kërkesëpadia e paditëses duhet të aprovet si e bazuar. Për gjykatën e as për palët nuk ishte kontestuese se paditësja është në marrëdhënie pune tek e paditura si mësimdhënës në shkollën “SHFMU “...” në Han të Elezit. Më tutje, vërtetohet se paditësja ka realizuar 263 ditë punë dhe ditë mësimi tek e paditura. Po ashtu, gjykata ka parasysh edhe faktin se pala e paditur përgjatë seancave gjyqësore nuk e ka kundërshtuar kërkesëpadinë sa i përket shujtave, por vetëm sa i përket kamatës ligjore.

Andaj, si rrjedhojë në bazë të provave të administruara gjykata vlerëson se kërkesëpadia e paditëses është e bazuar sa i përket kompensimit të shujtave, meqë e njëjta është e punësuar si mësimdhënëse, po ashtu e drejta e tillë rrjedh nga kontrata kolektive, shumë e cila është 2 euro në ditë, andaj meqë

me vërtetimin e punës rezulton se ka realizuar 263 ditë pune, i takon shuma sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Lidhur me pretendimin e palës së paditur që pagesa e shujtës mos të llogaritet me kamatën prej 8%, gjykata e gjen si të pabazuar në kuptim të nenit 382 të LMD-së, i cili parasheh se *“Debitori që vonon në përmbushjen e detyrimit në të holla debiton, përpos borxhit kryesor, edhe kamatën. Lartësia e kamatëvonesës është tetë përqind (8%) në vit, përveç nëse parashihet ndryshe me ligj të veçantë”*. Pra, meqë gjykata ka vërtetuar se e paditura obligohet të përmbushë pagesën e shujtave pra një e drejtë e cila i takon palës paditëse dhe nuk është përmbushur me kohë, sjell edhe detyrimin e palës së paditur për përmbushjen e kamatës ligjore sa i përket shumës kryesore.

Ndërsa, sa i përket pjesës refuzuese të kërkesëpadisë lidhur me shpenzimet e udhëtimit, gjykata fillimisht konstaton se i autorizuari i palës së paditur ka sjell certifikatën mbi librin amzë të të kurorëzuarve dhe të lindjes, ndërsa nuk ka certifikatë të vendbanimit që të kuptohet se ku jeton paditësja. Po ashtu, edhe biletat që janë ofruar nga ana e palës paditëse janë në gjuhën maqedone, përkundrajt se në seancën e datës 13.12.2024, ishte obliguar i autorizuari i palës paditëse që provat t'i sjellë në gjuhën zyrtare që është në përdorim në gjykatë.

Sipas nenit 35 paragrafi 5 të Kontratës Kolektive 105 e datës 22.01.2021 parashihet se *“Punonjësve arsimorë që udhëtojnë në vendbanimet e komunës përkatëse ku punojnë u paguhen shpenzimet e rrugës 70% të biletave të trafikut urban”*. Nga interpretimi i dispozitës në fjalë, rrjedh se e drejta e tillë iu takon punonjësve që udhëtojnë në vendbanimin e komunës ku punojnë, pra fjala *përkatëse* sjell interpretimin që duhet punuar dhe udhëtuar brenda komunës.

Për më tepër, neni 7 i LPK-së, parasheh se *“Palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla”*. Meqenëse nuk janë ofruar prova të mjaftueshme për të përcaktuar vendbanimin e paditëses e as shpenzimet eventuale që i janë shkaktuar, gjykata erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditësit sa i përket kësaj pjese është e pabazuar.

Lidhur me shpenzimet e procedurës, gjykata vendosi si në dispozitivin nën pikën e tretë, ashtu që e detyroi palën e paditur që paditëses t'ia paguaj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 404.40 euro, edhe atë shume prej 104,00 euro, për përpilim e padisë, shumen prej 135,20 euro për përfaqësim në dy seance gjyqësore si dhe pagesën e taksës në shumë prej 30,00 euro, e tërë kjo bazuar në nenin 452.1 të LPK-së.

Nga të cekurat në kuptim të nenit 143 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të aktgjykimit.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ – Dega në Kaçanik

Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil

2023:165784 më datë 27.12.2024

Gjyqtare

Alba Makolli

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 7 ditësh nga marrja e të njëjtit, përmes kësaj gjykate për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.